

URDHËR I PËRBASHKËT

Nr. 444, datë 15.7.2025

PËR PËRCAKTIMIN E NDARJES SË TË ARDHURAVE, KRITEREVE E PROCEDURAVE TË ADMINISTRIMIT DHE SHPËRNDARJES SË TË ARDHURAVE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës dhe të nenit 14, pika 2 të ligjit nr. 8/2023, “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror”, ministri i Drejtësisë dhe ministri i Financave,

URDHËROJNË:

1. Objekti i këtij urdhri është përcaktimi i ndarjes së të ardhurave, kriterëve e procedurave të administrimit dhe shpërndarjes së të ardhurave që arkëtojnë Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit dhe zyrat përmbarimore vendore nga masa e tarifës fikse të veprimit përmbarimor dhe vlera e tarifës së suksesit për veprimet përmbarimore të ofruara nga shërbimi përmbarimor gjyqësor shtetëror.

2. Të ardhurat e përfituara nga kryerja e veprimeve përmbarimore, i kalojnë në masën 10% Shërbimit Përmbarimor Shtetëror, ndërsa 90% derdhen në buxhetin e shtetit.

3. Masa e të ardhurave të përfituara nga Shërbimi Përmbarimor Shtetëror shpërndahet në mënyrë përpjestimore, si më poshtë:

a) në masën 60%, për shpërblimin e punonjësve të nivelit qendror dhe vendor të Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror;

b) në masën 20%, për investime;

c) në masën 20%, për mallra dhe shërbime të tjera.

4. Shërbimi Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror, për shërbimin që kryejnë si Agjent Tatimor, përfitojnë komision, të cilin e marrin në rrugë buxhetore. Ky komision llogaritet në përqindje mbi shumat e arkëtuara të të ardhurave që kanë transferuar në llogari të Drejtorisë Rajonale Tatimore për Buxhetin e Shtetit.

5. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit dhe zyrat përmbarimore vendore për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Ulsi Manja

MINISTËR I FINANCIVE
Petrit Malaj